

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

**Nr. 47, datë 18. 06. 2004**

**PËR  
MIRATIMIN E “RAPORTIT TË POLITIKËS MONETARE  
PËR MUAJIN MAJ TË VITIT 2004”**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Politikave Monetare, në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë “Raportin e Politikës Monetare për muajin maj të vitit 2004”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Politikave Monetare me dërgimin e këtij raporti në : Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për botimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI  
Ylli MEMISHA**

**KRYETARI  
Shkëlqim CANI**

**BANKA E SHQIPËRISË**

**RAPORTI MUJOR  
I  
POLITIKËS MONETARE**

Maj 2004

## **PËRMBAJTJA**

- I. Zhvillimet kryesore të muajit
- II. Ecuria e inflacionit në muajin maj
  - II.1 Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse
  - II.2 Faktorët që kanë ndikuar në ecurinë e inflacionit
- III. Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare
  - III.1 Politika monetare e Bankës së Shqipërisë
  - III.2 Ecuria e agregatëve monetarë
  - III.3 Kërkesa e ekonomisë për para
    - III.3.1 Mjetet valutore neto
    - III.3.2 Kërkesa e qeverisë për para
    - III.3.3 Kredia për ekonominë
  - III.4 Tregjet financiare dhe ecuria e normave të interesit
    - III.4.1 Tregjet financiare
    - III.4.2 Ecuria e normave të interesit
  - III.5 Ecuria e kursit të këmbimit

## I. ZHVILLIMET KRYESORE TË MUAJIT

- Inflacioni vjetor në muajin maj zbriti në 2.6 për qind, duke rezultuar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Norma mesatare e inflacionit vjetor ishte 3.19 për qind.
- Ulja e inflacionit në muajin maj erdhi si pasojë e futjes më të hershme të prodhimit bujqësor vendas në treg në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu, ndikim ka dhënë edhe rishikimi në zbritje i disa prej çmimeve të administruara.
- Banka e Shqipërisë ka lehtësuar kushtet monetare në muajt prill dhe maj. Ajo ka ulur me 0.5 pikë përqindjeje normën bazë të interesit. Lehtësimi i politikës monetare erdhi si rezultat i parashikimeve pozitive për inflacionin në të ardhmen duke synuar të mbështesë më mirë kreditimin e ekonomisë dhe aktivitetin ekonomik të vendit.
- Bankat e nivelit të dytë i janë përgjigjur në të njëjtin kah uljes së normës bazë të interesit. Gjatë muajve maj-qershor ato kanë ulur normat e interesit të depozitave me afat në lekë dhe *yield*-et e bonove të thesarit.
- Ngadalësimi i normës vjetore të rritjes së agregatit M2, i cili ka reflektuar një kërkesë më të ulët të qeverisë dhe të ekonomisë për mjete monetare në lekë, ka ndikuar në uljen e ritmit të rritjes së ofertës monetare për muajin prill. Depozitat në valutë kanë lëvizur në drejtim të kundërt. Kontributi i tyre në rritjen e ofertës monetare ka rezultuar më i lartë.
- Teprica e kredisë u rrit me 2.6 miliardë lekë në muajin prill, duke qenë pothuaj në të njëjtin nivel me rritjen e saj gjatë tremujorit të parë. Në muajin prill u lëvrua 10.6 miliardë lekë kredi e re ose 54 për qind më shumë në krahasim me të njëjtin muaj të vitit të kaluar.
- Likuiditeti në muajt prill dhe maj ka qenë në nivele të qëndrueshme. Ai ka reflektuar rritjen e moderuar të depozitave në lekë dhe kërkesën e ulët për fonde të qeverisë.
- Leku është gjendur në pozita të favorshme ndaj monedhave usd dhe euro, i mbështetur nga ulja e importit dhe nivelet e ulëta të inflacionit.

## II. ECURIA E INFLACIONIT NË MUAJIN MAJ.


### II.1 Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse.

Norma e inflacionit vjetor në muajin maj zbriti në 2.6 për qind, nga 3.2 për qind një muaj më parë. Niveli i inflacionit mesatar vjetor në muajin maj shënoi 3.19 për qind, duke qëndruar praktikisht në të njëjtin nivel me muajin paraardhës. Ulja e inflacionit në këtë muaj erdhi si pasojë e futjes më të hershme të prodhimit bujqësor vendas në treg në krahasim me vitin e kaluar. Ky faktor ndikoi në uljen e çmimeve të produkteve bujqësore duke patur ndikimin kryesor në vlerën negative të inflacionit mujor, -1.7 për qind, dhe në uljen e vlerës së inflacionit total. Gjithashtu, ndikim në uljen e inflacionit vjetor ka dhënë edhe rishikimi në zbritje i çmimeve të energjisë elektrike dhe të telefonisë fikse, si dhe mbiçmimi i monedhës vendase.

Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).


	2000	2001	2002	2003	2004
Janar	-1.3	2.2	6.5	0.0	3.3
Shkurt	-1.3	1.5	7.6	1.1	4.4
Mars	-2.1	2.9	7.5	1.3	4.0
Prill	-1.4	3.0	6.5	2.3	3.2
Maj	-0.1	2.5	4.6	2.8	2.6
Qershor	0.1	4.0	3.7	2.6	
Korrik	-1.3	5.6	4.2	3.0	
Gusht	-0.7	4.1	5.5	3.0	
Shtator	0.9	3.5	5.3	2.8	
Tetor	1.8	1.8	5.8	2.9	
Nëntor	1.9	2.8	3.7	3.4	
Dhjetor	4.2	3.5	1.7	3.3	
<b>Mesatar</b>	<b>0.05</b>	<b>3.1</b>	<b>5.2</b>	<b>2.4</b>	

Grrafik 1. Inflacioni vjetor (në përqindje).



Në ndryshim nga muajt e mëparshëm, kur ecuria e inflacionit u përcaktua nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji”, ulja e konsiderueshme e inflacionit të grupit gjatë muajit maj “Ushqime dhe pije joalkolike” solli uljen e normës së inflacionit.

Grafik 2. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor total (në pike përqindje).



Muaji maj shënoi pikënisjen e periudhës gjatë së cilës inflacioni në vend pasqyron efektin sezonal të uljes së çmimeve të produkteve ushqimore, si rrjedhojë e futjes së prodhimit vendas. Oferta e rritur e prodhimit bujqësor vendas në muajin maj ndikoi në uljen e çmimeve të produkteve bujqësore. Inflacioni vjetor i grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” në këtë muaj, shënoi një normë negative prej -1.1 për qind, në krahasim me një inflacion prej 5.5 për qind në muajin maj 2003. Kontributi i grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” në inflacionin vjetor pësoi rënie nga 2.34 pikë përqindjeje në maj 2003, në -0.48 pikë përqindjeje në muajin maj 2004.

Tabelë 2. Norma mujore dhe vjetore e grupit “Ushqim dhe pije joalkolike”.

	"Ushqim dhe pije joalkolike"		"Fruta"		"Zarzavate"	
	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore
Maj'04	-4.2	-1.1	-2.6	6.0	-21.0	-14.8
Maj'03	-3.0	5.5	7.3	13.1	-18.7	21.3


Megjithëse grupi “Ushqime dhe pije joalkolike” shpjegon uljen e inflacionit të muajit maj, grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” vazhdon të kontribuojë në mënyrë të rëndësishme në inflacionin vjetor. Kontributi i këtij grupi, në inflacionin vjetor shënoi 2.3 pikë përqindjeje. Inflacioni vjetor i këtij grupi në muajin maj rezultoi 9.7 për qind; 1.3 pikë përqindjeje më i ulët se inflacioni vjetor i tij në muajin prill. Nëngrupi “Lëndë djegëse dhe energji” regjistroi një inflacion vjetor 27.2 për qind, normë më e ulët sesa ajo e inflacionit të prillit prej 35.1 për qind. Ulja e çmimit të gazit shihet si faktor në uljen e inflacionit të këtij nëngrupi. Masat e ndërmarra nga organizmat shtetërorë përkatës për kontrollin

e standardeve dhe për disiplinimin e tregtimit të këtij produkti, mendohet të kenë influencuar në rritjen e cilësisë dhe në zvogëlimin e kostove të tepërta, duke sjellë reduktimin e çmimit të tij.

Rritja në 1.5 për qind e inflacionit vjetor të grupit “Transport” në muajin maj, reflektoi rritjen e çmimit të naftës. Norma mujore e inflacionit të nëngrupit “Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit”, ku përfshihet nafta, u rrit me 2.3 pikë përqindjeje në krahasim me muajin prill. Tregjet botërore të naftës janë karakterizuar nga rritje të çmimit të naftës, si pasojë e rritjes së pasigurisë në vendet e Lindjes së Mesme. Tensionet gjeopolitike bëjnë që ecuria e ardhshme e çmimeve të naftës dhe ndikimi i saj në inflacion të jenë ende subjekt i shumë paqartësive.


Grupet e tjera kanë vërtetuar sjelljen e tyre sezonale, duke mos u luhatur në mënyrë të ndjeshme.

Grafik 3. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).



Norma mujore e inflacionit prej -1.7 për qind vazhdon trendin e tre viteve të mëparshëm, duke qenë poshtë mesatares historike.

Grafik 4. Ecuria e inflacionit mujor të muajve maj.




## II. 2 Faktorët që kanë ndikuar në ecurinë e inflacionit.

Prej një periudhe të gjatë kohore, faktorët e kërkesës kanë kontribuar pozitivisht në krijimin e një mjedisi të favorshëm për kontrollin e inflacionit dhe mosushtrimin e presioneve negative ndaj tij.

Politika monetare e zbatuar nga Banka e Shqipërisë ka vazhduar të jetë e kujdeshme, duke kontribuar në kontrollin e treguesve monetarë dhe të presioneve inflacioniste në ekonomi. Norma e ulët e interesit bazë dhe rrjedhimisht kostoja e ulët oportune e mbajtjes së parasë, kanë vazhduar të furnizojnë rritjen sipas parashikimeve të ofertës monetare. Rritja e kënaqshme e depozitave në lekë dhe në valutë ka sjellë një situatë të qëndrueshme likuiditeti, duke kontribuar në qëndrueshmërinë e normave të interesit.


Grafik 5. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në përqindje).



Shpenzimet buxhetore gjatë muajit mars janë rritur në mënyrë të moderuar, duke qëndruar gjithmonë brenda niveleve të parashikuara për tremujorin e parë. Realizimi i kujdeshëm i këtyre shpenzimeve, gjatë një harku kohor relativisht të gjatë, krijon premisa që ky faktor të mos ndikojë negativisht në rritjen e presioneve inflacioniste nëpërmjet shtimit të kërkesës në ekonomi ose edhe nëpërmjet rritjes së kërkesës për para të qeverisë.



Grafik 6. Ecuria e shpenzimeve buxhetore të vitit 2003 (përqindje ndaj PBB-së).



Muaji maj dallohet edhe për ndikimin pozitiv të faktorëve të ofertës në ecurinë e inflacionit. Përveç efektit pozitiv të futjes së prodhimit bujqësor vendas dhe uljes së disa prej çmimeve të administruara (të analizuar gjerësisht më sipër), ecuria e çmimeve në ekonomi është ndikuar edhe nga zbutja e efektit të inflacionit të importuar.

Inflacioni i importuar, është një faktor që ndikon në mënyrë të pashmangshme inflacionin në vend. Presionet inflacioniste që burojnë nga ky faktor, kohët e fundit kanë qenë në zbutje. Normat më të ulëta të inflacionit të regjistruar në Itali dhe Greqi, si dhe mbiçmimi, në bazë vjetore i lekut ndaj euros dhe dollarit, përkatësisht 9.1 për qind dhe 12.5 për qind, kanë frenuar efektet rritëse të inflacionit të importuar në inflacionin tonë.

Tabelë 3. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në për qind).

	Tetor '03	Nëntor '03	Dhjetor '03	Janar '04	Shkurt '04	Mars '04	Prill '04
Greqi	3.2	3.4	3.1	3.1	2.6	2.9	3.1
Itali	2.8	2.8	2.5	2.2	2.4	2.3	2.3


Ulja e normës së inflacionit vjetor në muajin maj, erdhi kryesisht si pasojë e efektit zbritës sezonal që solli hyrja e prodhimit bujqësor vendas. Ky efekt u shfaq më shpejt gjatë vitit 2004 në krahasim me vitin 2003 dhe, për pasojë, ndikimi i tij pritet të zbutet në muajt e verës. Gjithsesi, faktorët që ndikojnë mbi inflacionin në vend kanë qenë nën kontroll dhe krijojnë një lloj konforti për respektimin e objektivit të inflacionit për vitin 2004.

### III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

#### III.1 Politika monetare e Bankës së Shqipërisë

Duke ndjekur dhe vlerësuar në vazhdimësi ecurinë e treguesve monetarë përballë nevojës së respektimit të objektivit të inflacionit, Banka e Shqipërisë lehtësoi më tej kushtet monetare në muajt prill dhe maj. Ajo uli me 0.5 pikë përqindjeje normën bazë të interesit<sup>1</sup>. Ky lehtësim erdhi si rezultat i parashikimeve pozitive për inflacionin në të ardhmen. Gjithashtu, analiza e kushteve monetare në ekonomi dhe, në veçanti, tendencat mbiçmuese të lekut ndaj euros dhe usd, ulja e raportit të parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare në nivelin minimal historik dhe ecuria ende nën trend e rritjes vjetore të M1 real, tregojnë se ekonomia ka mundësi të thithë një stimul të mëtejshëm monetar, pa e kthyer atë në presione inflacioniste. Në këtë këndvështrim, ulja e normave të interesit synon nxitjen e mëtejshme të kredithënies dhe të aktivitetit ekonomik në tërësi.

Grafik 7. Rritja vjetore e M1 real.



Bankat e nivelit të dytë kanë reaguar në të njëjtin kah ndaj uljes së normës së repos. Gjatë muajit maj dhe javës së parë të muajit qershor, bankat e nivelit të dytë kanë ulur normat e interesit për depozitat me afat 3, 6 dhe 12-mujor përkatësisht me 0.34, 0.52 dhe 0.56 pikë përqindjeje, ndërkohë që normat e interesit të bonove të thesarit për të njëjtat maturitete, janë ulur respektivisht me 0.16, 0.2 dhe 0.27 pikë përqindjeje. Ulja e normave të interesit të depozitave pritet të pasohet edhe nga ulje të normave të kredithënies në lekë.

Banka e Shqipërisë ka vazhduar të tërheqë likuiditetin e tepërt të sistemit bankar me anë të përdorimit të instrumentit të marrëveshjeve të riblerjes me çmim fiks dhe me shumë të pakufizuar. Banka e Shqipërisë ka patur si partnere në transaksionet e saj valutore vetëm Ministrinë e Financave, pa dhënë kështu ndikim në tregun valutor. Gjatë muajit prill, qeveria ka depozituar në Bankën e Shqipërisë 126 milionë usd, shumë kjo e siguruar nga privatizimi i Bankës së

<sup>1</sup> Banka e Shqipërisë e uli me dy hapa normën bazë të interesit. Vendimi i parë ishte në fund të muajit prill dhe i dyti në fillim të muajit maj. Në të dyja rastet norma e repos u ul me 0.25 pikë përqindjeje.

Kursimeve. Përdorimi i gjysmës së të ardhurave valutore të qeverisë për shlyerjen e borxhit të brendshëm është kryer pjesërisht gjatë muajit maj. Në zbatim të këtij vendimi, qeveria ka pakësuar me 3.5 miliardë lekë borxhin e brendshëm gjatë muajit maj.

Banka e Shqipërisë ka respektuar objektivat e saj sasiorë gjatë muajve prill dhe maj.

Tabelë 4. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.


	Shtat. '03	Dhjetor '03	Mars 04	Prill 04	Maj 04*
<b>Realizimi i objektivit të rezervës ndërkombëtare neto (në milionë dollarë)</b>					
Objektivi	576.2	583.2	619.2	623.8	628.5
Aktuale	614.3	673.9	678.8	799.2	796.5
Diferenca	38.2	90.7	59.6	175.4	168.0
<b>Realizimi i objektivit të mjeteve të brendshme neto (në miliardë lekë)</b>					
Objektivi	89.1	93.1	80.1	80.8	81.5
Aktuale	73.3	68.5	61.7	44.8	44.9
Diferenca	-15.9	-24.6	-18.4	-35.9	-36.6
<b>Realizimi i objektivit të kredisë së brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë)</b>					
Objektivi	278.1	280.9	286.1	285.8	284.5
Aktuale	276.0	280.1	286.1	285.6	--
Diferenca	-2.1	-0.7	0.0	-0.2	--

\* Të dhënat për muajin maj janë operative.

### III. 2 Ecuria e agregatëve monetarë

Ritmi vjetor i rritjes së ofertës monetare shënoi një rënie të lehtë krahasuar me muajin e kaluar, duke arritur në 8.1 për qind në muajin prill. Në këtë ecuri ka ndikuar ngadalësimi i normës vjetore të rritjes së agregatit M2, i cili nga ana e tij ka reflektuar një kërkesë më të ulët të qeverisë dhe ekonomisë për mjete monetare në lekë. Në drejtim të kundërt kanë lëvizur depozitat në valutë, kontributi i të cilave në rritjen e ofertës monetare ka rezultuar më i lartë.

Grafik 8. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.




Oferta monetare në terma mujorë ka pësuar një rritje prej 0.2 për qind. Kjo është mbështetur tërësisht nga rritja me 1.4 miliardë lekë e depozitave në valutë, ndërkohë që depozitat në lekë kanë shënuar një rënie mujore prej 0.8 miliardë lekësh. Treguesi i parasë jashtë bankave ka ndaluar rënien e tij, duke u rritur lehtësisht me 0.16 miliardë lekë.

Norma vjetore e rritjes së depozitave në valutë është drejt përafërimit me vlerat e saj historike. Në fund të muajit prill, rritja vjetore e tyre rezultoi 11.5 për qind. Mbiçmimi i lekut ndaj monedhës evropiane euro gjatë muajit prill, vlerësohet të ketë ndikuar negativisht në nivelin e depozitave në valutë me rreth 0.8 miliardë lekë. Në terma vjetorë efekti negativ i kursit të këmbimit arrin në 13 miliardë lekë ose rreth 12.5 për qind. Edhe gjatë këtij muaji, rritjen më të madhe brenda depozitave në valutë e kanë patur depozitat pa afat, çka lidhet me normat e ulëta të interesit për depozitat me afat në valutë.

Ngadalësimi i kërkesës për mjete monetare në lekë, i shoqëruar me nivelin e qëndrueshëm të parasë jashtë bankave, ka çuar në rënien me 0.3 për qind të depozitave në lekë gjatë muajit prill. Norma e rritjes vjetore të tyre ka vijuar tendencën rënëse të saj, duke zbritur në 12.5 për qind nga 14 për qind që ishte një muaj më parë.

Grafik 9. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3.



Muaji prill ka shënuar një qëndrueshmëri të nivelit të parasë jashtë bankave, pas kthimit në sistem të një pjese të saj gjatë muajve të parë të vitit. Niveli i parasë jashtë bankave gjatë këtij muaji është rritur lehtësisht, ndërsa raporti i saj ndaj ofertës monetare qëndroi i pandryshuar. Norma vjetore e parasë jashtë bankave në prill, ndonëse ende në nivele negative, thekson tendencën e saj për t'iu kthyer niveleve normale.

Tabelë 5. Ecuria e treguesve monetarë në muajin prill (në miliardë lekë).

	Prill	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
	2004	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Paraja jashtë bankave	117.3	0.2	0.1	-2.6	-2.2
Depozitat totale	339.4	0.6	0.2	36.9	12.2
- në lekë	234.9	-0.8	-0.3	26.1	12.5
- në valutë	104.4	1.4	1.3	10.8	11.5
Depozita pa afat	63.6	-0.6	-1.0	4.6	7.9
- në lekë	22.3	-1.4	-6.1	-0.3	-1.3
- në valutë	41.3	0.8	2.0	4.9	13.6
Depozita me afat	275.8	1.2	0.4	32.2	13.2
- në lekë	212.6	0.6	0.3	26.4	14.2
- në valutë	63.1	0.6	0.9	5.8	10.1
M1	139.6	-1.3	-0.9	-2.9	-2.1
M2	352.2	-0.7	-0.2	23.5	7.1
M3	456.7	0.7	0.2	34.2	8.1
Baza monetare	154.4	0.0	0.0	1.7	1.1

### III. 3. Kërkesa e ekonomisë për para


#### III. 3. 1 Mjetet valutore neto

Sistemi bankar rezulton me një rritje prej 96.5 milionë dollarë në nivelin e mjeteve valutore neto. Rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë ka dhënë një efekt pozitiv në këtë rritje ndërsa efekti i mjeteve valutore neto i bankave të nivelit të dytë ka qënë i kundërt. Në muajin prill rezervat valutore neto të Bankës e Shqipërisë janë rritur me rreth 116 milionë dollarë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i hyrjes së të ardhurave të privatizimit të Bankës së Kursimeve në shumën prej 126 milionë dollarë. Ndërkohë, nënçmimi i euros ndaj dollarit me 2.6 për qind gjatë muajit prill, ka ndikuar në uljen e vlerës së investimeve të rezervës në euro, të shprehura në dollarë.

Mjetet valutore neto të bankave të nivelit të dytë kanë shënuar ulje me rreth 19.8 milionë dollarë. Kjo ulje ka ardhur si pasojë e rritjes në masën 2.6 miliardë

lekë të teprcës së kredisë në valutë<sup>2</sup> gjatë muajit prill, edhe pse ky muaj ka vijuar të shënojë rritje të depozitave në valutë me rreth 1.4 miliardë lekë.

Grafik 10. Ecuria e mjeteve valutore neto të sistemit bankar.



### III.3. 2 Kërkesa e qeverisë për para


Llogaritë fiskale shënojnë një deficit buxhetor prej 3.7 miliardë lekësh në muajin prill 2004. Financimi i brendshëm i tij vazhdon të kryhet në pjesën më të madhe nga sistemi bankar. Financimi vjetor i deficitit buxhetor nga sistemi bankar gjatë muajit prill ishte 1.9 miliardë lekë, duke bërë që financimi kumulativ i deficitit buxhetor të arrijë në 6.9 miliardë lekë<sup>3</sup> në fund të muajit prill. Deficiti buxhetor është financuar kryesisht nëpërmjet bonove të thesarit dhe obligacioneve dyvjeçare. Bankat e nivelit të dytë kanë ulur portofolin e bonove të thesarit me rreth 0.8 miliardë lekë krahasuar me një muaj më parë, ndërsa individët dhe institucionet kanë rritur portofolet e tyre përkatësisht me rreth 0.7 dhe 1.2 miliardë lekë. Portofoli i Bankës së Shqipërisë nuk ka patur ndryshime.

Qeveria ka vijuar të emetojë obligacione qeveritare edhe gjatë muajit prill. Shuma e tyre që nga fillimi i vitit arriti në 1.3 miliardë lekë, nga të cilat 0.5 miliardë lekë janë emetuar në muajin prill.

<sup>2</sup> Kredi në valutë për sektorin privat dhe për institucione financiare.

<sup>3</sup> Diferenca e deficitit me financimin përbën gjendjen e depozitës së qeverisë prej 3.2 miliardë lekësh.

Grafik 11. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).




### III.3.3 Kredia për ekonominë

Kreditimi i ekonomisë ka shënuar një përshejtim të dukshëm në muajin prill. Teprica e kredisë për ekonominë u rrit me 2.6 miliardë lekë gjatë këtj muaji; rritje kjo pothuajse e barabartë me rritjen e shënuar gjatë tremujorit të parë të vitit dhe 30 për qind më e lartë se ajo e realizuar në muajin prill të vitit 2003. Krahasuar me fundin e vitit 2003, teprica e kredisë është rritur me 5.3 miliardë lekë ose 47 për qind më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Sektori privat dhe individët janë kredituar mesatarisht me 1.4 miliardë lekë në muaj, nivel që është pothuajse i barabartë me ritmin e parashikuar të kreditimit të ekonomisë në programin monetar.

Grafik 12. Ecuria mujore e tepricës së kredisë.



Në fund të muajit prill 2004, teprica e kredisë afatmesme dhe afatgjatë arriti në 56 për qind të kredisë gjithsej, nga 54.5 për qind që ishte në fund të vitit 2003. Bankat, në përgjithësi, kanë filluar të ndihen më të sigurta në kreditimin afatgjatë të biznesit privat, duke dhënë kontributin e tyre në rritjen ekonomike të vendit. Struktura sipas monedhave lekë/valutë vazhdon të ruajë raporte të

njëjta me atë të fundit të vitit 2003, 80 me 20. Teprica e kredisë në valutë vazhdon të jetë mbizotëruese në këtë strukturë.

Tabelë 6. Ecuria e treguesve të tepricës së kredisë, në përqindje.

	Viti 2002	T-1'03	T-2'03	T-3'03	T-4'03	T-1 '04	Prill'04
Kredi afatshkurtër	53.8	53.2	53.4	51.4	45.5	44.4	44
Kredi afatmesme	30.1	30.4	30.7	30.5	37.0	34.4	35
Kredi afatgjatë	16.1	16.4	15.9	18.1	17.5	21.2	21
Lekë	21.3	21.5	21.2	19.3	19.6	20	20
Valutë	73.7	78.5	78.8	80.7	80.4	80	80
Teprica e kredisë(në mld lekë)	38.7	40.4	44.5	48.0	50.6	53.4	55.97

Struktura e tepricës së kredisë sipas degëve të ekonomisë është shoqëruar me ndryshime të peshave. Kështu, vihet re një tendencë në rënie e pjesës që përbën dega e tregtisë duke i kaluar degëve të tilla si industri përpunuese, bujqësi, ndërtim etj..

Gjatë muajit prill të vitit 2004 u lëvrua 10.6 miliardë lekë kredi e re; 54 për qind më shumë se në muajin prill të vitit të kaluar. Kredia e re e lëvruar gjatë periudhës janar-prill 2004 është rreth 39 miliardë lekë ose 58 për qind më shumë se gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2003. Kredia afatshkurtër, e cila përbënte 65 për qind të kredisë së re të lëvruar në këtë muaj, vazhdon të mbetet forma dominuese e kreditimit. Po kështu, kreditimi në valutë, i cili përbënte 77 për qind të kredisë së re të muajit prill, mbetet forma kryesore e kreditimit.

Tabelë 7. Ecuria e kredisë së re në vite, në miliardë lekë.

	2002	2003	T-1 '03	T-2 '03	T-3 '03	T-4 '03	T-1 '04	Prill '04
Kredi afatshkurtër	44.7	63.1	11.6	17.5	15.6	18.3	18.7	6.9
Kredi afatmesme	13.0	22.2	4.3	5.6	4.2	8.0	5.7	2.3
Kredi afatgjatë	4.8	7.4	1.5	1.5	1.8	2.6	3.5	1.4
Sektori shtetëror	0.06	0.04	0.05	0.0	0.0	0.0	0.0	0
Sektori privat	62.5	92.6	17.4	24.6	21.6	28.9	27.9	10.6
Lekë	20.8	30.8	7.1	8.0	7.4	8.3	8.80	2.4
Valutë	41.8	61.8	10.4	16.6	14.2	20.6	19.10	8.2
Kredi e re(në mld lekë)	62.6	92.6	17.5	24.6	21.6	28.9	27.9	10.6



Kredia e re e akorduar në muajin prill të vitit 2004 ka patur si destinacion kryesor, në masën 41 për qind, financimin e aktiviteteve tregtare. Ndërkohë, kreditimi i industrisë përpunuese me rreth 10 për qind, financimi i blerjeve të pasurive të patundshme në masën 15 për qind dhe kreditimi i degës së ndërtimit në masën 6 për qind janë aktivitetet më të kredituara nga sistemi bankar. Gjithashtu, një rritje të vazhdueshme gjatë periudhës janar-prill ka lëvrimi i kredive të reja në degën e bujqësisë. Për katër muajt e parë të vitit 2004 janë lëvruar 248 milionë lekë për sektorin bujqësor.

### III. 4. Tregjet financiare dhe ecuria e normave të interesit


#### III. 4. 1 Tregjet financiare

Gjendja e likuiditetit në sistemin bankar gjatë muajve prill-maj 2004 ka qenë e qëndrueshme. Niveli mesatar i likuiditetit në muajin maj shënonte 4.3 miliardë lekë, duke u ulur me rreth 0.3 miliardë lekë në krahasim me muajin prill. Bazuar në të dhënat operative, niveli i likuiditetit në muajin maj është ndikuar nga rritja e moderuar e depozitave në lekë dhe nga ulja e financimit të deficitit buxhetor nga sistemi bankar.

Për tërheqjen e likuiditetit të tepërt gjatë këtyre dy muajve është përdorur instrumenti i repos njëjavore me interes të përcaktuar. Gjatë kësaj periudhe kjo normë ndryshoi dy herë duke zbritur nga 6.5 për qind në 6.0 për qind. Niveli aktual i normës së repos, e cila është dhe norma bazë e interesit në ekonomi, është niveli më i ulët i shënuar që nga fillimi i përdorimit të këtij instrumenti.

Në muajin maj bankat kanë përdorur lehtësinë e depozitës njëditore mesatarisht rreth tre herë më pak se në muajin prill. Tregu ndërbankar është karakterizuar nga një rritje e aktivitetit të tij si për nga vëllimi ashtu dhe nga lloji i transaksioneve. Niveli mesatar i transaksioneve në muajin maj shënoi 0.58 miliardë lekë nga 0.43 miliardë në muajin prill. Numri dhe vëllimi i transaksioneve njëjavore ka qenë më i lartë në muajin maj krahasuar me muajin prill.

Grafik 13. Niveli i likuiditetit të sistemit bankar pranë Bankës së Shqipërisë (në milionë lekë.)



### III. 4. 2 Ecuria e normave të interesit

Qetësia e normave të interesit në tregjet monetare gjatë muajit prill nuk ka vazhduar gjatë. Bankat i janë përgjigjur dy sinjaleve të njëpasnjëshme të Bankës së Shqipërisë – reduktimit me nga 0.25 pikë përqindjeje të normës bazë të interesit në fund të muajit prill dhe në fillim të muajit maj. Pas këtyre vendimeve të Bankës së Shqipërisë, normat e interesit kanë ndryshuar si më poshtë (periudha 28 prill-31 maj).

Tabelë 8. Reagimi i tregjeve pas ndryshimit të normës bazë të interesit (28 prill-31 maj).

Maturiteti	Depozitat në lekë*	Yield-i i bonove të thesarit
3 - mujore	-0.34	-0.16
6 - mujore	-0.52	-0.20
12 - mujore	-0.56	-0.26


\*Ndryshimi mesatar i ponderuar sipas struktures së depozitave.

Në tregun ndërbankar, normat e interesit janë ulur me rreth 0.3 pikë përqindjeje, si për transaksionet njëditore ashtu dhe për ato njëjavore.

Përsa i përket tregut të kredive, të dhënat e disponueshme datojnë në fund të muajit prill. Krahasuar me një muaj më parë, norma e interesit mesatar të ponderuar të kredive është rritur me 0.9 pikë përqindjeje. Ky ndryshim diktohet kryesisht nga zhvendosja e strukturës së kredisë drejt kredive më afatgjata gjatë muajit prill. Megjithatë, duket se në këtë treg bankat nuk reagojnë ndaj sinjaleve të bankës qendrore në të njëjtën masë dhe shpejtësi si në tregun e depozitave.

Në tregun primar vihet re një rritje e konkurrencës për shkak të ofertës më të lartë në raport me kërkesën e qeverisë për likuiditet. Për më tepër, vlerat nominale të letrave me vlerë të maturuara në këtë periudhë kanë qenë më të larta sesa ato të emetuara nga qeveria, e cila, gjithashtu, në përgjithësi e ka ulur kërkesën e saj për financim nga sistemi bankar.

Grafik 14. Ecuria e *yield*-it të bonove të thesarit.




Krahasuar me një muaj më parë, në prill normat e interesit të depozitave në dollarë, kanë patur tendencë të lehtë rritëse në të gjitha afatet. E kundërta ka ndodhur me normat e interesit në euro, duke reflektuar kështu tendencën e përgjithshme në tregjet ndërkombëtare. Niveli mesatar i ponderuar i interesave për depozitat në valutë është i ulët: 0.75 për qind për dollarin dhe 1.44 për qind për euron.

Në tregun e kredive në valutë tendenca e ndryshimeve të normave të interesit në përgjithësi ka qenë e ndryshme për euron dhe dollarin amerikan. Norma mesatare e ponderuar e kredive në euro pa kësuar rritje (+0.83 pikë përqindjeje) dhe ajo e usd ka pësuar rënie (-0.17 pikë përqindjeje).

### III. 5 Ecuria e kursit të këmbimit

Muaji maj është karakterizuar nga një lek i fortë. Kjo periudhë e vitit shoqërohet me hyrjen e produktit bujqësor vendas dhe reduktimin e importeve, duke ulur kërkesën për valutë dhe duke kontribuar në mbiçmimin e lekut. Gjithashtu, vlera e lekut në këmbimin me valutën e huaj është mbështetur edhe nga niveli i ulët i inflacionit. Gjatë gjithë muajit, leku është tregtuar në një bandë të ngushtë kundrejt të dyja valutave kryesore duke u mbiçmuar ndaj dollarit me rreth 2.2 për qind dhe nënçmuar kundrejt euros me 0.1 për qind. Llogaritur që nga fundi i vitit 2003, leku pozicionohet i mbiçmuar kundrejt të dyja monedhave. Mbiçmimi është më i dukshëm kundrejt euros, me 4.9 për qind ndërsa ndaj dollarit mbiçmimi është 1.9 për qind.

Grafik 15. Ndryshimi vjetor i kursit mesatar të këmbimit të lekut.



Periudha e muajve të verës zakonisht, është karakterizuar nga një lek i mbiçmuar. Kjo pritet të ndodhë edhe këtë vit, pavarësisht efektit që mund të japë ulja më e fundit e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

**Nr. 48, datë 18. 06. 2004**

**i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për të miratuar rregulloren**

**“PËR DISA NDRYSHIME NE RREGULLOREN PËR PROKURIMIN E MALLRAVE, TË SHËRBIMEVE DHE TË NDËRTIMEVE NE BANKËN E SHQIPËRISË”**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Shërbimeve Logjistike, në bazë të nenit 43, gërma (c) të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për prokurimin e mallrave, të ndërtimeve dhe të shërbimeve në Bankën e Shqipërisë” miratuar me vendimin nr. 15, datë 26.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë të bëhen ndryshimet e mëposhtme :
  - a) Në kreun II “Zgjedhja e procedurës së prokurimit”, neni 8 “Kushtet dhe kufijtë monetarë për përdorimin e “Tenderit të kufizuar”” paragrafi :

Për shërbimet - 3.000.000 lekë (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja), me përjashtim të projekteve, ku si referim do të merret vlera e parashikuar për sipërmarrjen e ndërtimit të objektit dhe jo ajo e shërbimit.

**Ndryshon në :**

Për shërbimet - 3.000.000 lekë (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja), me përjashtim të kontratave afatgjata të shërbimit, ku si referim do të merret vlera e parashikuar për realizimin e shërbimit në një vit kalendarik.

- b) Në kreun II “Zgjedhja e procedurës së prokurimit”, neni 9 “Kushtet dhe kufijtë monetarë për përdorimin e “Ftesës për kuotim””, paragrafi:

1.000.000 lekësh (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja) për shërbimet.

**Ndryshon në :**

1.000.000 lekësh (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja) për shërbimet me përjashtim të kontratave afatgjata të shërbimit, ku si referim do të merret vlera e parashikuar për realizimin e shërbimit në një vit kalendarik.

**c) Në kreun III “Tender i hapur kombëtar”, neni 16 “Modifikimet e dokumenteve të tenderit”:**

Komisioni i Prokurimit, në çfarëdo kohe përpara mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së ofertave, me iniciativën e tij ose në përgjigje të një kërkesë nga një kandidat që ka blerë dokumentet e tenderit, mund t'i modifikojë ato duke hartuar shtojcë, e cila bëhet pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit. Çdo shtojcë duhet t'i njoftohet menjëherë të gjithë kandidatëve të mësipërm.

Modifikimi i dokumenteve të tenderit si më lart, bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së ofertave.

Në qoftë se modifikimi i dokumenteve të tenderit cënon përgatitjen dhe dorëzimin në kohë të ofertave në datën e caktuar, Komisioni i Prokurimit me gjykimin dhe argumentimin e tij, shtyn këtë datë brenda një afati të arsyeshëm.

**Ndryshon në:**

Sqarimi dhe/ose modifikimi i dokumenteve të tenderit .

Komisioni i Prokurimit, në çfarëdo kohe përpara mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së ofertave, me iniciativën e tij ose në përgjigje të një kërkesë nga një kandidat që ka blerë dokumentet e tenderit, mund t'i modifikojë ato dhe njofton kandidatët për këtë modifikim.

Kërkesat për modifikimin/sqarimin e dokumenteve të tenderit pranohen deri në 5 (pesë) ditë para mbarimit të afatit të paraqitjes së ofertave.

Si rregull, komisioni vendos për dhënien e sqarimeve ose për modifikimin e dokumenteve jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga paraqitja e kërkesës.

Komisioni i Prokurimit do t'i përgjigjet me shkrim çdo kërkesë për sqarime që mund të marrë brenda afateve të caktuara kohore. Kopje të përgjigjes u dërgohen menjëherë të gjithë kandidatëve që kanë blerë dokumentet e tenderit.

Kur komisioni vendos të modifikojë dokumentet e tenderit afati i fundit i pranimit të ofertave do të jetë jo më pak se 5 ditë nga njoftimi i kandidatëve për këtë modifikim. Ky afat nuk do të tejkalojë afatin minimal të njoftimit të përcaktuar për procedurën përkatëse të tenderimit.

**d) Në kreun V “Procedura ndërkombëtare prokurimi”, neni 24, “Tender i kufizuar ndërkombëtar” :**

Procedura e tenderit të kufizuar ndërkombëtar do të respektojë dispozitat e nenit 19 të kësaj rregulloreje dhe dispozitën e mëposhtme:

Afati nga data e njoftimit të kandidatit deri në datën e pranimit të ofertave është jo më pak se 40 ditë kalendarike.

### **Ndryshon në :**

Procedura e tenderit të kufizuar ndërkombëtar është e njëjtë me procedurën e tenderit të hapur kombëtar me përjashtim që:

Njoftimi për tender u adresohet një numri jo më të vogël se 3 kandidatësh të huaj, të kualifikuar.

Afati nga data e njoftimit të kandidatit deri në datën e pranimit të ofertave është jo më pak se 35 ditë kalendarike.

#### **e) Në kreun V “Procedura ndërkombëtare prokurimi”, neni 25, “Ftesa për kuotim ndërkombëtar”:**

Procedura e “Ftesës për kuotim ndërkombëtar” është e njëjtë me atë që zbatohet në “Ftesën për kuotim kombëtar”, me përjashtim :

- a) që kandidatëve të huaj u kërkohet si dokumentacion për kualifikim vetëm regjistrimi në dhomën përkatëse të tregtisë ose regjistrimi në gjykatë;
- b) kur kandidatët janë vetëm të huaj kuotimi dhe dokumentacioni për kualifikim mund të pranohen me faks.

### **Ndryshon në:**

Procedura e “Ftesës për kuotim ndërkombëtar” është e njëjtë me atë që zbatohet në “Ftesën për kuotim kombëtar”, me përjashtim që:

- a. ftesa i adresohet një numri jo më të vogël se 3 kandidatësh të huaj të kualifikuar;
- b. kandidatëve të huaj u kërkohet si dokumentacion për kualifikim vetëm dokumenti që vërteton zotësinë juridike për të vepruar të kandidatit;
- c. kur kandidatët janë vetëm të huaj, kuotimi dhe dokumentacioni për kualifikim mund të pranohen me faks.

#### **f) Në kreun VIII “Realizimi i procedurës së prokurimit”, neni 45 “Kërkesat për prokurim” shtohen paragrafët e parë dhe pika (dh) me përmbajtjen si vijon:**

Enti prokurues për ndërtime, afati kohor i realizimit të të cilave kërkon vazhdimin e punimeve dhe në vitin/vitet pasardhës kalendarikë, prokuron fondet dhe mbikëqyrjen e tyre sipas vlerës së plotë të këtyre objekteve.

Enti prokurues për shërbime që kërkohen të shtrihen në vitin/vitet kalendarik/e pasardhës, prokuron sipas vlerës së plotë të objektit.

Çdo objekt i prokuruar me vlerën e plotë, që shtrihet në më shumë se një vit kalendarik, detyrimisht përfshihet në buxhetin e vitit/ viteve pasardhës për vazhdimin dhe realizimin e këtij objekti.

- dh) Miratimin e Këshillit Mbikëqyrës për realizimin e objektit të prokurimit nëpërmjet kontratave me kohëzgjatje më shumë se një vit kalendarik.
- e) Kohëzgjatjen maksimale për kontratat me afat më të gjatë se një vit kalendarik.
- g) Në kreun VIII “Realizimi i procedurës së prokurimit”, neni 46 “Nxjerrja e urdhrin të prokurimit”**

Pas marrjes së kërkesave për prokurim, Departamenti i Administrimit përgatit dhe harton urdhrin e prokurimit, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Entit Prokurues.

Në urdhrin e prokurimit do të përfshihen:

- a) objekti i prokurimit (kur është e mundur me sasi të dhe me afatet kohore përkatëse);
- b) fondi limit i vënë në dispozicion;
- c) procedura e prokurimit dhe lloji i saj (kombëtare ose ndërkombëtare ose e kombinuar) dhe në rastin e prokurimit të drejtpërdrejtë, emri i kandidatit;
- ç) anëtarët e Komisionit të Prokurimit;
- d) mënyra që do të ndiqet në hapjen dhe në shqyrtimin e ofertave (në përputhje me nenin 18 të kësaj rregulloreje).

#### **Ndryshon në :**

Pas marrjes së kërkesave për prokurim, Departamenti i Shërbimeve Logjistike përgatit dhe harton urdhrin e prokurimit, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Entit Prokurues.

Në urdhrin e prokurimit do të përfshihen:

- a) objekti i prokurimit (kur është e mundur me sasi të dhe me afatet kohore përkatëse);
- b) fondi limit i vënë në dispozicion i shprehur në lekë për procedurat kombëtare dhe/ose në valutë për procedurat ndërkombëtare dhe për ato të kombinuara;
- c) procedura e prokurimit dhe lloji i saj (kombëtare, ndërkombëtare ose e kombinuar) dhe në rastin e prokurimit të drejtpërdrejtë, emri i kandidatit;
- ç) anëtarët e Komisionit të Prokurimit;
- d) mënyra që do të ndiqet në hapjen dhe në shqyrtimin e ofertave (në përputhje me nenin 18 të kësaj rregulloreje), për procedurat tender i hapur dhe i kufizuar;
- dh) kohëzgjatja maksimale për kontratat me afat më të gjatë se një vit kalendarik.

**h) Në kreun VIII "Realizimi i procedurës së prokurimit", neni 49 "Kompetencat dhe detyrat kryesore të Komisionit të Prokurimit", paragrafi :**

Anëtarët, Kryetari i Komisionit të Prokurimit si dhe juristi i angazhuar në procedurën e prokurimit shpërblehen me shumën prej 1000 lekësh. Ky shpërblim do të jepet mbas shpalljes së ofertuesit fitues. E drejta për shpërblim humbet për mospjesëmarrje në 2(dy) mbledhje të komisionit.

**Ndryshon në :**

Anëtarët e caktuar për të marrë pjesë në Komisionin e Prokurimit shpërblehen me shumën prej 1000 lekësh. Ky shpërblim do të jepet mbas shpalljes së ofertuesit fitues. E drejta për shpërblim humbet për mospjesëmarrje në 2(dy) mbledhje të komisionit.

**i) Në kreun VIII "Realizimi i procedurës së prokurimit", neni 53 "Shpallja e ofertës fituese dhe njoftimi i ofertuesit fitues" paragrafi:**

Në rast se ofertuesi fitues nuk pranon të lidhë kontratë dhe tërhiqet, kjo dokumentohet dhe shpallet fituese oferta e klasifikuar e dyta. Në këtë rast, komisioni do të gjykojë lidhur me efektshmërinë e vlefshmërisë së kësaj oferte të dytë, duke marrë në konsideratë anën ekonomike të saj dhe do të vendosë, sipas rastit, të lidhet ose jo kontratë me ofertuesin i klasifikuar i dyti.

Në rast se komisioni vendos të mos lidhet kontratë me ofertuesin, i klasifikuar i dyti, procedura anulohet.

**Ndryshon në :**

Nëse ofertuesi fitues, brenda afatit kohor të përcaktuar në dokumentet e tenderit, nuk pranon të lidhë kontratë, enti prokurues bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe nëse diferenca ndërmjet ofertës së klasifikuar në vendin e parë dhe asaj të klasifikuar në vendin e dytë, do të jetë jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, atëherë do të shpallet si fitues pjesëmarrësi i renditur i dyti në klasifikim.

Në raste urgjente, kur diferenca ndërmjet ofertës së klasifikuar në vendin e parë dhe asaj të klasifikuar në vendin e dytë, do të jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, atëherë Departamenti i Shërbimeve Logjistike, me miratim të Kryetarit të Entit Prokurues, paraqet në Këshillin Mbikëqyrës projektvendimin për lidhjen e kontratës me ofertuesin i klasifikuar i dyti.

**dhe paragrafi :**

Me nënshkrimin e kontratës, dosja e plotë e dokumenteve të prokurimit dhe një kopje e kontratës depozitohen në Arshivën e Bankës së Shqipërisë. Në të nuk



lejohe të bëhen korigjime dhe mund t'i jepet për shqyrtim vetëm personave të autorizuar,

**Ndryshon në :**

Me nënshkrimin e kontratës, dosja e plotë e dokumenteve të prokurimit dhe një kopje e kontratës depozitohen në Arshivën e Bankës së Shqipërisë, ku ruhen dhe administrohen sipas mënyrës dhe kohës që parashikohet në ligjin për arkivat dhe në ligjin për informimin publik, si dhe në rregulloret përkatëse të Bankës së Shqipërisë. Në të nuk lejohe të bëhen korigjime dhe mund t'i jepet për shqyrtim vetëm personave të autorizuar.

**j) Në kreun X “Kushte të veçanta të prokurimit” neni 60 “Për shërbimet” paragrafi:**

Sipas rastit konkret dhe gjykimit të komisionit ose të Departamentit të Administrimit, për kontratat afatgjata të shërbimit, shuma e sigurimit të kontratës mund të parashikohet që të reduktohet sipas periudhave të përcaktuara të kryerjes së shërbimit.

**Ndryshon në :**

Sipas rastit konkret dhe gjykimit të komisionit ose të Departamentit të Shërbimeve Logjistike, për kontratat e shërbimit, shuma e sigurimit të kontratës mund të parashikohet që të reduktohet sipas periudhave të përcaktuara të kryerjes së shërbimit.

**k) Në kreun XI “Dispozita të fundit”, neni 62 “Lista e ofertuesve të përjashtuar”:**

Kontraktuesit, që sipas gjykimit të Bankës së Shqipërisë nuk kanë realizuar kontratën sipas kushteve të saj ose kandidatët, që për kualifikimin e tyre kanë dhënë informacione të rreme, do të përjashtohen nga pjesëmarrja në prokurimet për vitin e ardhshëm.

Banka e Shqipërisë (Departamenti i Administrimit) në fillim të çdo viti boton në Buletinin Zyrtar si dhe në website-n e saj, listën e ofertuesve ose të kandidatëve të përjashtuar nga marrja pjesë në prokurimet në Bankën e Shqipërisë.

**Ndryshon në :**

Me propozim të Departamentit të Shërbimeve Logjistike (Sektorit të Prokurimit), Kryetari i Entit Prokurores vendos për përjashtimin nga prokurimet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë nga 1- 3 vjet të:

- kandidatëve që për kualifikimin e tyre sipas kërkesave të nenit 35 kanë paraqitur dokumente të rreme;
- ofertuesve që kanë paraqitur dokumentacion të rremë;
- ofertuesve të shpallur fitues që janë tërhequr nga lidhja e kontratës;
- kandidatëve/ofertuesve që paraqesin informacione të rreme ose keqdashëse;
- kontraktuesve me të cilët është zgjidhur kontrata për mosrespektim të kushteve kontraktore.

Vendimi i komunikohet Agjencisë së Prokurimit Publik dhe botohet në Buletinin Zyrtar si dhe në website-n e Bankës së Shqipërisë.

Në rregullore zëvendësohet në çdo rast emërtimi “Departamenti i Administrimit” me emërtimin “Departamenti i Shërbimeve Logjistike”.

2. Ngarkohen të gjitha strukturat e Bankës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS**  
**Shkëlqim CANI**

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004**

1. Vendim nr. 01, datë 28. 01. 2004. Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003”
2. Vendim nr.02, datë 28.01. 2004. Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS”.
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004. Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr. 75, datë 25.09. 2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004. Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SWIFT” miratuar me vendimin nr. 16, datë 01.03. 2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01. 2004. Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004**

1. Vendim nr. 06, datë 11.02. 2004. Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr. 07, datë 11.02. 2004. Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004**

1. Vendim nr. 08, datë 25.02.2004. Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004. Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr. 10, datë 25.02.2004. Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.
5. Vendim nr. 12, datë 25. 02. 2004. “Për miratimin e bilancit dhe për

përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003”.

6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004. Për “Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo-Shqiptare”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004**

1. Vendim nr. 16, datë 10.03.2004. Për “Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare”.
2. Vendim nr. 17, datë 10. 03. 2004. “Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004**

1. Vendim nr. 20, datë 24.03.2004. Për miratimin e rregullores “Mbi kredinë brenda ditës”.
2. Vendim nr.21, datë 24.03.2004. “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin “Për kapitalin rregullator të bankës” miratuar me vendimin nr. 57, datë 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr. 40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.
3. Vendim nr.22, datë 24.03.2004. Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”.
4. Vendim nr.23, datë 24.03.2004. Për “Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 6, Mars 2004**

1. Vendim nr. 26, datë 14. 04. 2004. Për lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredidhënës nga Banka e Kursimeve
2. Vendim nr. 27 datë 14. 04. 2004. “Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 7, Prill 2004**

1. Vendim nr. 28, datë 28 04. 2004. Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.
2. Vendim nr. 29, datë 28 04. 2004. Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi kredinë njëditore”
3. Vendim nr. 30, datë 28. 04. 2004. Për dokumentin e “Politikës Operative të Mbikëqyrjes”.
4. Vendim nr. 31, datë .28 04. 2004. Për “Emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 8, Maj 2004**

1. Vendim nr. 35, datë 12 05. 2004. Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të të riblerjes”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 9, Maj 2004**

1. Vendim nr. 36, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e Raportit “Vlerësimi i ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2004”.
2. Vendim nr. 37, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare tek grupi financiar ICB HOLDING AG.
3. Vendim nr. 38, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e rregullores “Për adiministrimin e aktveve të qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë”.
4. Vendim nr. 39, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e rregullores “Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 10, Qershor 2004**

1. Vendim nr. 46, datë 09. 06. 2004. Për “Politikën e përdorimit të internetit dhe e-mail”.